


NE EMER TE POPULLIT



Gjykata Themelore në Gjiilan- Dega ne Novoberde, Departamenti i Përgjithshem- dega e Novoberde, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me procesmbajtësen Mimoza Mekaj, e cila është nën hetim penale kundër të akuzuarit N H , nga fshati , Komuna e Prishtinës, të cilin e mboron av. Murat Demolli, nga Prishtina, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 2 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjiilani, PP.nr.2508/2014 të dt. 26.11.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më 27.07.2015 si dhe seancave gjyqësore të mbajtura me 15.02, 04.04, 30.05, 27.06, 28.08, 26.09.2016, dhe më datë 27.09.2016, mori dhe publikisht komunikoi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N H , pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati B dhe e ëma F , e lindur I , i lindur më fsh. , tani me vendbanim në fshatin , Komuna e Prishtinës, Shqipëtar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i 3 femijve, din shkrim dhe lexim, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, i panunë, gjer me tani kinse i padënuar më pare për ndonjë vepër tjetër penale si dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Në mbështetje të nenit 390 parag. 1 nën parag. 3 i KPPK-së,

Lirohet nga akuza

Kinse më datë 09.06.2014, rreth ores 11.00 min, ne territorin e fshatit , Komuna e Novobërdës, në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur " " , në parcelën nr.1253 me qëllim vjedhje ti ketë prerë 267 copë trungje të llojit Bung, me diametër në cung 15-65cm, në lartësi të drurit 20-62 cm, në gjatësi prej 10-18m, me vëllim të përgjithshëm prej 205.3m3, dhe në këtë mënyrë ta ketë dëmtuar APK-në, Zyra në Novobërdë, në shumë prej 27.800,10euro, me qka kishte për të kryer Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 2 te KPRK-se.

-me qka kishte për të kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 para. 2 të KPRK-ës.

E dëmtuara APK, zyra në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në contest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjiilan-Departamenti i Përgjithshem me aktakuzën PP.nr.2508/2014 te dates 26.11.2014 e ka akuzuar N H , nga fshati për shakk të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 2 te KPRK-se.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, ne fjalën përfundimtare ka deklaruar: Me provat e administruara konsideroj se me padyshim është vertetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale si në dispozitivin e aktakuzës, andaj edhe i propozoj gjykatës që të njejtin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptojë dënim meritor sipas ligjit gjithnjë duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Murat Demolli, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: gjatë këtij procesi gjyqësor duke i përfshirë edhe deklaratat e dëshmitarëve si dhe provat e tjera materiale të ofruara nga mbrojtja si aktgjykimi i gjykatës themelore në Gjilan, nr.29/2014, me të cilin është aprovuar kërkesë padia e paditesve B. K., R. K., B. K. dhe M. K., ndaj të paditurës Komunës së Novobërdës, është vërtetuar se paditësit janë bashkëpronar nga ¼ pjesë ideale e paluajtshmerisë së ngastrës 2253-0, në sipërfaqe prej 11.60.08 ha, pastaj nga prova tjetër si leja për prerjen e druve e lëshuar nga APK, ne Prishtinë, si dhe fletedamkosjea për pyjet private e cila i është dhënë tani të mrbojturit tim për prerjen e pyllit, pastaj qertifikata mbi të drejtat e pronësisë dhe bazuar në të gjitha këto prova shihet se i mbrojturi im nuk është kryes i kësaj vepre penale, andaj edhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta lirojë nga akuza.

I akuzuari N. H., në mbrojtjen e tij ka deklaruar: nuk e ndiej veten fajtor veprën penale të cilën ma ve ne barre aktakuza dhe ka shtuar: jam i papune dhe me teper se 20 vite merrem me shitblerjen e pyjeve të cilat me pastaj pas nxerrjes se lejeve per prerje nga organet kompetente edhe te njejtat ua shes qytetarve. Malin kontestues e kam blere ne baze te kontratës gojore. Pas blerjes njeri prej shitësve në vendin e ngjarjes mi ka treguar kufijtë, dhe ma ka ofruar edhe fletën poseduese në mënyrë që pastaj unë të pajisem me lejen për prerjen e drunjve në malin kontestues. Me fletën posedues të ofruar nga shitsit nga organi kompetent pas pagesës së të gjitha taksave të nevojshme organi kompetent në Prishtinë, ma ka lëshuar edhe lejen për prerjen e malit të lëshuar nga argani kompetent, kam shkuar në mal dhe kam filluar prerjen e druve ku gjatë prerjes së malit. Pas kompletimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm kam filluar edhe prerjen e malit kështu në vend të ngjarjes kanë ardhur zyrtarët e APK-se, të Prishtinës, dhe pas ofrimit të dokumentacionit të cilin ua kam prezentuar edhe e kanë bërë damkosjen e druve. Pas kësaj pas disa ditësh në vend të ngjarjes kanë dalur zyrtarët e APK-së të Novobërdës, dhe meqë lejen për prerjen e malit e kisha harruar në shtëpi të njëjtëve u kam treguar se si ditë më parë kishin qenë zyrtarët e APK-së, te Prishtinës, dhe e kishin bërë damkosjen e druve te prera dhe pasi që te nejtit kanë bërë shiqimin dhe verifikimin e këtyre druve të damkosura më kanë urdhëruar që ta ndërprejë prerjen e malit të cilin më parë e kisha blerë, pas kësaj e kam njoftuar pronarin i cili pas nje apo dy ditësh pronari M. K., dhe dy inspektor nga Prishtina, kanë ardhur në vendin e ngjarjes dhe të njëjtit me kanë thenë që ta ndërprej prerjen e malit derisa të verifikohet vija kufitare e malit ndërmjet Komunës së Prishtinës, dhe Komunës së Novobërdës, për qka edhe ashtu kam vepruar e kam ndërprerë prerjen e malit dhe drutë të prera perpos një sasi të cilën e kam bartur dhe vendosur në afërsi të rrugës për ti bartur më lehtë ndersa drute tjera kane ngelur te shperndara nëpër mal te pabartura te cilat edhe sod e kesaj dite besoj se gjenden ne mal. Andaj nuk e ndiej veten fajtor per kete vepër penale dhe i propozoj gjykatës që e me liroje.

Meqense i akuzuari N. H., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale gjykata ka shtjelluar provat dhe atë me dëgjimin e dëshmitarëve N. B., teknik i pylltarisë në Novobërdë, S. A. asistent i bujqësisë pranë KK. Novoberde, S. O., pylltar pranë APK-së në Novobërdë, B. K. si dhe ka bërë leximin e këtyre provave materiale dhe atë ka lexuar fletëparaqitjen për dëmtimin e pyllit nr.23 të datës 10.11.2014, ka lexuar shkresën e drejtorisë për bujqësi, pylltari, dhe zhvillim rural, nr.23 te dates 10.11.2014, ka lexuar aktgjykimin e gjykatës themelore në Gjilan Cnr.29/14 te dates 23.02.2016, ka lexuar lejen për prerjen e drunjve ne pyllin privat ne emer te R. K., nr 02/14 te dates 05.06.2016, ka lexuar fletedamkosjen nr.12-006619, te dates 08.05.2014 te leshuar nga APK ne Prishtine, ka lexuar fletëpagesën lëshuar nga "Pro Credit Bank" të datës 05.06.2014, ka lexuar kërkesën nr.04-322-87472 te dates 28.03.2014, ka lexuar qertifikaten pronësore nr.04899-4 te dates 25.03.2014, se bashku me kopjen e planit nr.71903041 te dates 25.03.2014.

Dëshmitari N. B., ka deklaruar: Se ditën kritike me 09.06.2014, kam qene ne vendin e ngjarejs ne fshatin , ku e kam takuar tani te akuzuarin duke bartur dru me traktor te markes Rakovica, e te cilat dru kanë qeneë te damkosura me vulë të APK-se, ne Prishtinë, dhe meqe i akuzuari nuk ka patur me vete ndonjë document, dhe nuk e kam ditur se mali kontestues a gjendet në teritorin e Komunës së Novoberdës apo të Komunën e Prishtinës, pasi që në Drejtorin e

gjeodezis të Komunës së Novobërdës, e kemi nxjerrur skicën ku në bazë të kësaj skice është konstatuar se mali në të cilin i ka prerë drutë tani i akuzuari, i takon teritorit të Komunës së Novobërdës, andaj edhe në bazë të kësaj unë e kam ushtruar fletëkallëximin penal në bazë të shënimeve të cilat mi ka ofruar kolegu S. A. roje pylli në Novobërdë. Unë nuk e di se fshati , a ka qenë më herët në teritorin e Komunës së Prishtinës, apo të Novobërdës. Nuk ma mer mendja së APK në Prishtinë, të ketë mundur të lëshojë leje për prerjen e druve pa i ofruar palapronari i pyllit ndonjë dokument qoftë fletën poseduese, skicën apo ndonjë dokument tjetër.

Dëshmitari , ka deklaruar se më datë 09.06.2014, kam takuar të akuzuarin me traktor i cili ka qenë duke i paluar drutë në livadh dhe i njëjti ka deklaruar se drutë të prera kanë qenë të malit në pronësi private e të cilat dru kanë qenë të damkosura por i njëjti nuk ka patur dokument me vete për lejen e prerjes së malit. Se roja e pyllit të atij territori kolegu Sllavisha Gjokiq, dhe inspektorët më vonë kanë konstatuar se vendi ku janë prerë drutë nga ana e të akuzuarit ka qenë pronë shoqërore dhe pas kësaj kemi ushtruar edhe fletëparaqitjen.

Dëshmitari , në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar : se nga drejtori A. G. , kemi marur urdhër që unë së bashku me kolegët S. A. dhe S. Gj. që të shkojnë në fshatin , dhe të kontsatojnë se a janë prerë disa dru në pyllin privat apo shtetëror dhe në baze të kësaj urdhëresë kemi shkuar në vendin e ngjarjes e kanë takuar të akuzuarin i cili ka deklaruar se drutë i ka prerë në malin privat. Se në vendin e ngjarjes kanë parë drutë të prera të damkosura dhe se nuk e kemi ditur se drutë a kanë qenë të prera në malin shtetëror apo privat.

Dëshmitari B. K. , në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: pyellin kontestues e kemi shfrytëzuar moti kohë për nevojat tona familjare, pa u penguar nga askush. Se malin tani kontestu gjat vitit 2014 ja kemi shitur tani të akuzuarit N. , dhe atë vetëm për prerjen e druve. Pas shtije së këtij malli, në Drejtortin e APK –ës në Prishtinë, kemi kërkuar, lejen për prerjen e druve, për damkosjen e druve dhe me këtë rast edhe pse dokumentacioni i pronësisë së malit kontestues ka qenë në emër të gjyshit tim R. K. tani i ndjer, por këto kërkesa janë bërë në emër të tani të akuzuarit N. , në mënyrë që i njëjti të mund pa pengesa ta shfrytëzojë malin e blerë për prerje.

Nga leximi i fletë paraqitjes për dëmtimin e pyllit dhe fletëparaqitjes penale të date.10.11.2014, kundër tani të akuzuarit N. H. , gjykata ka konstatuar se me date 09.06.2014 rreth orës 11.00 në pyllin shtetëror, pronë e APK –ës Novobërdë, i ka prerë 267 cop dru të njoma bungu, për të cilat dru tani i akuzuari e ka pasur vendimin e APK-ës, Prishtinë, dhe të njëjtat kanë qenë të damkosura me cekicin nr.2.

Nga leximi i fletëdamkosjes të lëshuar nga Drejtoria e APK-ës, në Prishtinë. Nr. 12/006619 të dates 08.05.2014 gjykata ka vërtetuar se në pyllin e R. K. në ngastrën 04890-4 në sipërfaqe 10.05.71, ha bëhet zgjidhja dhe dëmkosja e trungjeve të prera.

Nga leximi i kërkesës për lëshimin e liqencës për prerjen e druve e lëshuar nga Drejtoria e APK-ës në Prishtinë, në emër të tani të akuzuarit N. H. , nr 04 322-87472 të dates 11.04.2014 gjykata ka vërtetuar se tani i akuzuari N. , i është drejtuar Drejtorisë së APK-ës, në Prishtinë, për lëshimin e liqencës për prerjen e druve në pyllin privat, në Zonën kad. M. , në ngastrën kad nr. 4890-4 në sipërfaqe prej 10.07.01 ha. të llojit bung dhe ahu.

Nga leximi i fletëpagesës së Pro Credit Bank të dates 05.06.2014 gjykata ka vërtetuar se tani i akuzuari N. H. , në emër të R. K. për lejen e prerjes së drunjve ka pagur shumën prej 723.00 euro.

Nga leximi e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C. nr 29/2014 të dates 23.02.2016, gjykata ka vërtetuar se B. K. , R. K. B. K. dhe M. K. , janë bashkronar me nga ¼, pjesë ideale të ngastrës kad. nr 0-1253-0, në sipërfaqe prej 11.60.08 ha, në vendin e quajtur " " e regjistruar si prone shtetërore e Kuvendit Komunal të Novobërdës, dhe e ka obliguar të paditurën Komunën e Novobërdës, që këtë të drejtë të ua njohu paditësve këtë të drejtë dhe të duroj që kjo palujshmëri në DGJKP të regjistrohet në emër të bashkpronarëve të lartë cekur.

Nga provat e shtjelluara dhe faktet e konstatuara më lartë gjykata ka vërtetuar se: tani i akuzuari N H nga bashkpronarët R K etj, në bazë të marrveshtjes verbale e ka blerë malin kontestues për prerje. Pas shitblerjes bashkpronarët e malit të shitur, tani të akuzuarit për kompletimin e dokumentacionit për prerjen e malit ia ofrojnë edhe fletën poseduese. Pas marrjes së fletës poseduese si dhe pas pagesës së të gjitha taksave të nevojshme për nxerjen e lejes, i akuzuari, i drejtohet organit kompetent APK-ës në Prishtinë, i cili edhe ia lëshon lejen për prerjen e drunjve në malin kontestues. Pas marrjes së lejes tani i akuzuari fillon prerjen e malit, pastaj në vendin e ngjarjes dalin zyrtarët-rojet e pyllit të APK-ës, të Prishtinës, të cilët pas prezentimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e tani të akuzuarit të njejtit edhe e bëjnë edhe damkosjen e drunjve, ndërsa tani i akuzuari vazhdon punën e tij. Pas një kohe në vendin e ngjarjes dalin pylltarët e APK –ës, të zyrës së Novobërdës, e takoj tani të akuzuarin duke prerë dhe bartur dru në malin kontestues, kasi konstatojnë se drut ishin të damkosura por tani i akuzuari nuk e kishte me vete lejen për prerjen e druve, ndërsa pylltarët nuk e dijnë kufirin e malit kontestues, dhe për këtë e lajmrojnë Drejtorin e APK-ës, në Novobërdë, e cila i drejtohet Drejtorisë së Gjeodezisë, në Novobërdë, për ta caktuar kufirin në mes të malit të teritorit të Komunave Prishtinë dhe Novobërdë, e cila konstaton se mali kontestues gjendet në teritorin e komunës së Novobërdës, dhe në bazë të këtij konstatimi APK, zyra në Novobërdë, ushtron kallximin penal ndaj tani të akuzuarit, për veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-ës, ndërsa bashkpronarët të cilët më parë ia kishin shitur malin tani të akuzuarit, për ta mbrojtur të njejtin menjëher ushtrojnë padi për vertetimin e pronësisë të malit kontestues në Gjykatën Themelore në Gjiilan, e cila me aktgjykimin e saj C. nr. 29/2014 të dt. 23.02.2016 ua vërteton bashkpronarëve R K etj, të drejtën e pronësisë të malit kontestues.

Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktikisht kjo gjykatë erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit N H nuk qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, andaj edhe të njejtin në mungesë të provave e lirë nga akuzat.

E dëmtuara APK, në Novobërdë, në kuptim të nenit 112 paragrafi 3 i KPPK-së, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 103 paragrafi 1 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
-DEGA NE NOVOBERDE,**

Më datën 27.09.2016

Procesmbajtësja,
Mimoza Mehmeti

Gjyqtari,
Hasan Sadiku

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën, e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.